



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:054932

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05620530

P.nr.142/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtorin profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të akuzuarit B.M. për shkak të veprës penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.80/2023 të datës 02.03.2023 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 24.04.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Albana Parduzi, i pandehuri B.M.dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit, avokat Sabit Pllana, me datë 25.04.2024 e shpalli publikisht dhe në të njëjtën ditë e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.M., nga i ati M., e ëma Z., e vajzërisë SH. i lindur me datë ..., në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, në fshatin Rekë, Rr. “...”, Komuna e Mitrovicës, me numër personal, i papunë, rast social, i pamartuar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 13.08.2022, rreth orës 14:00, në shtëpinë e tij në Rr. “.....-Rekës në Mitrovicë, i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që: pasi që zyrtarët policor zbatojnë një urdhër verbal të gjykatës për kontroll të shtëpisë së të pandehurit nën dyshim të kryerjes së veprës penale Rrëmbim (.....) dhe Dhunim (.....), gjatë kontrollit të shtëpisë së tij i gjejnë në posedim një sasi të vogël të substancës së dyshuar narkotike marihuanë dhe një mjet për bluarjen e marihuanës që i posedonte pa autorizim, e cila substancë narkotike sipas Raportit të Ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë të datës 25.11.2022 nga mostrat e marra nga dëshmia #1 ka rezultuar të jenë narkotik i llojit Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë të përgjithshme neto prej 1.9 ± 0.0007 gram, e cila me procesverbalin e kontrollit të shtëpisë dhe me vërtetimin mbi marrjen e përkohshëm të gjësendeve është sekuestruar nga Policia e Kosovës.

Me këtë ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 dhe 269 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 449, 450, dhe 452 të KPP-së i:

G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400.00 (*me fjalë: katërqind*) euro, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- II. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprën tjetër penale në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- III. Në mbështetje të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPP-së, nga i akuzuari KONFISKOHEN sendet, dhe atë: Substancë narkotike Marihuanë, në sasi prej 1.9 ± 0.0007 gram, me përmbajtje Tetrahidrokanabinol (THC) dhe mulliri i bluarjes së narkotikut, dhe Urdhërohet Policia e Kosovës që të njëjtat t'i shkatërrojë sipas procedurave ligjore në fuqi, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë euro (20) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20), të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- V. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.80/2023 të datës 02.03.2023, kundër të akuzuarit B.M., për shkak të veprës penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 24.04.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Albana Parduza, i akuzuari B.M.dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit me shkrim, avokati Sabit Pllana.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimit

të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, i ka propozuar gjykatës se me rastin e caktimit dhe llojit të dënimit si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa si rrethanë rënduese të merr parasysh rrezikshmërinë e kësaj vepre penale.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokat Sabit Pllana, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: pas konsultimit me të mbrojturin e tij i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, ndërsa sa i përket sanksionit penal, i ka propozuar gjykatës që si rrethana lehtësuese të merren parasysh pranimi i fajësisë, pendimin e të pandehurit për kryerjen e kësaj vepre, i pa gjykuar më par dhe gjendjen e dobët ekonomike.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit i datës me numër të rastit 2022-DHTN-362 i datës 13.08.2022; Procesverbali mbi marrjen në pyetje i të dyshuarit, i datës 13.01.2023; Shënimi zyrtar i hetuesit E.A., i datës 13.08.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me numër të rastit 2022-DHTN-362 i datës 13.08.2022; Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm dhe zingjiri i ruajtjes së provave të sekuestruara, me numër të rastit 2022-BI-96 dhe numër i rastit 2022-DHTN-362 i datës 13.08.2022; Urdhri për ekzaminimin forenzik të narkotikut, e datës 17.08.2022; Raporti i ekspertimit me nr. referues AKF/2022-3212/22-3138, I DATËS 25.11.2022, I Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; Foto albumi me gjithsejte dhjetë (10) foto, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri, me veprimet e tij, ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, e për të cilën vepër penale është paraparë dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Rrethana rënduese lidhur më këtë rast, gjykata vlerëson rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale

për faktin se veprat e tilla penale janë gjithnjë e më të shpeshta në vendin tonë, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë si dhe premtimin e bërë para gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit për të pandehurit sa i përket veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për zbutjen e dënimit në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-së, pasi që pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së, janë plotësuar kushtet për shqiptim të dënimit nën minimumin e paraparë me ligj.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë dhe me kusht ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Gjykata, vendimin për konfiskimin e substancës narkotike të gjetur tek i akuzuari, gjykata e mori konform nenit 269 par.3 të KPRK-së i cili parasheh "Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen" e lidhur me nenin 276 par.2 nën par. 2.4 të KPP-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata, duke u bazuar në nenin 242, 364, 449, 450, dhe 452 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.142/2023, datë 25.04.2024

Zyrtarja ligjore
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.